



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 916/3 Prot.

Tiranë, më 28 /09/2016

VENDIM

Nr. 67, datë 28/9 /2016

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale,

V Ë R E N:

Ankuesi/Qendra “Res Publica”, përfaqësuar nga Z. , ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit ankesën nr. 916 Prot., datë 01.09.2016, ndaj Bashkisë Sarandë, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumentave zyrtare”. Ankuesi në cilësinë e kërkuarit, me shkresën nr. 048/16 Prot., datë 26.07.2016 ka kërkuar nga Bashkia Sarandë t’i vihet në dispozicion informacioni si më poshtë:

1. *Kopje të Raportit Përfundimtar të Auditimit të kryer nga KLSH në Bashkinë Sarandë, me objekt: “Mbi vlerësimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, aktivitetit ekonomik e financiar, prokurimet me fonde publike, taksat dhe tarifat vendore, procedurat e shqyrtimit dhe miratimit të studimeve urbanistike, shesheve e lejeve të ndërtimit, lejeve të shfrytëzimit, administrimin e aseteve, dhënieve me qira të objekteve pronë publike, funksionimi i policisë bashkiake, etj” dhe masat për përmirësimin e gjendjes, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr.188, datë 31.12.2012.*
2. *Një kopje të të gjitha informacioneve të mëvonshme që Bashkia Sarandë ka raportuar në KLSH për përmbushjen e detyrave që i janë lënë sipas Raportit Përfundimtar të Auditimit të sipërpërmendur.*

Ankuesi pretendon se është cënuar në të drejtën për informim, pasi nuk është informuar lidhur me sa ka kërkuar dhe për këtë arsye ka depozituar ankim pranë Zyrës së Komisionerit. Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, Komisioneri pas vlerësimit të ankesës, bazuar në pikën 3 të nenit 24 të ligjit nr.119/2014, me shkresën nr.916/1 Prot., datë 05.09.2016 ka kërkuar nga Bashkia Sarandë, në cilësinë e Autoritetit Publik, të depozitohet brenda datës 09.09.2016 parashtrimet me shkrim mbi ankesën e paraqitur nga Qendra “Res Publica”.

Me shkresën nr. 2199/2 datë 08.09.2016 Bashkia Sarandë i ka kthyer përgjigje Qendrës “Res Publica”, duke argumentuar se bazuar në ligjin nr. 154/2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, ky informacion është konfidencial dhe autoriteti përgjegjës për vënien në dispozicion të këtij materiali është vetëm KLSH. Gjithashu Bashkia Sarandë, po në këtë shkresë udhëzon kërkuarin të drejtohet Kontrollit të Lartë të Shtetit për të marr informacionin e kërkuar.

Zyra e Komisionerit, pas shqyrtimit të ankesës si dhe pas konsultimit të legjislacionit, vlerëson se informacioni i kërkuar nga Qendra "Res Publica" mbi raportet e auditimit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit është informacion publik dhe dhënia e tij nuk mund të refuzohet. Në kuptim të nenit 2 pika 2 e Ligjit 119/2014, informacion publik është çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik, pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik. Çdo Autoritet Publik, në kuptim të nenit 7, pika 1, shkronja dh) të Ligjit 119/2014, duhet të ketë publik në programin e transparencës mekanizmat monitorues dhe të kontrollit që veprojnë mbi Autoritetin Publik, përfshirë planet strategjike të punës, raportet e auditimit nga KLSH ose subjekte të tjera, si dhe dokumentet që përmbajnë tregues të performancës së autoritetit.

Theksojmë, se e drejta për t'u informuar është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funksionimi i tyre do të ishte në interesin e të dy palëve.

Në këto kushte, në lidhje me ankesën e Qendrës "Res Publica" ndaj Bashkisë Sarandë, Komisioneri vlerëson se ankesa është e bazuar në ligj dhe si e tillë ajo duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24, nenit 25 të ligjit nr.119/2014 'Për të drejtën e informimit', shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr 49/2012 'Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative',

V E N D O S A:

1. Pranimin e ankesës së Qendrës "Res Publica", Nr. 916 Prot., datë 01.09.2016, ndaj Autoritetit Publik/Bashkisë Sarandë, me objekt "Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumenteve zyrtare".
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik/Bashkisë Sarandë, për vënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar (Kopje të Raportit Përfundimtar të Auditimit të kryer nga KLSH në Bashkinë Sarandë, me objekt: "Mbi vlerësimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, aktivitetit ekonomik e financiar, prokurimet me fonde publike, taksat dhe tarifat vendore, procedurat e shqyrtimit dhe miratimit të studimeve urbanistike, shesheve e lejeve të ndërtimit, lejeve të shfrytëzimit, administrimin e asetëve, dhënieve me qira të objekteve pronë publike, funksionimi i policisë bashkiake, etj" dhe masat për përmirësimin e gjendjes, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr.188, datë 31.12.2012. Një kopje të të gjitha informacioneve të mëvonshme që Bashkia Sarandë ka raportuar në KLSH për përmbushjen e detyrave që i janë lënë sipas Raportit Përfundimtar të Auditimit të sipërpërmendur.) brenda datës 05.10.2016.
3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani e këtij vendimi.
4. Ky vendim u dha sot në datë 28.9.2016.

Beshnik DERVISHI

KOMISIONERI